

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) si degë e Transparency International në Kosovë, fillon së zbatuari projektin e Qendrës për Avokim dhe Këshilla Ligjore (ALAC). Kjo iniciativë ka për qëllim që të ndihmoj dhe këshilloj në luftën kundër korrupsionit, denoncuesit, dëshmitarët dhe viktimat e korrupsionit në Kosovë. Nëpërmjet kësaj qendre viktimat e korrupsionit në Kosovë dhe dëshmitarët, do të mund të përfitojnë asistencë në ndërtimin e dosjes së tyre, përmes një avokati të angazhuar nga KDI për nevojat e Qendrës.

Kjo lloj asistence për viktimat dhe dëshmitarët e korrupsionit, ofrohet në shumë degë të Transparency International nëpër botë. Për herë të parë degët e TI në Bonjë Hercegovinës, Maqedoni dhe Rumani, në vitin 2003 kanë aplikuar këtë formë të asistencës, nëpërmjet të cilës kanë arritur rezultate të jashtëzakonshme në adresimin e rasteve të korrupsionit dhe përmirësimin e sistemit në vendet përkatëse.

Komponentët kryesore të qendrës:

*Linja telefonike pa pagesë*- ku viktimat e korrupsionit mund të marrin këshilla fillestare për të drejtat e tyre, ku në qoftë se ekziston dëshmia e korrupsionit, vazhdohet me konsultime ligjore të mëtejshme.

*Këshillat ligjore*- sigurohen përmes asistencës së këshilltarëve ligjor të punësuar në qendër, e që u ndihmojnë viktimave t'i artikulojnë, zhvillojnë dhe parashirojnë ankesat e tyre.

*Avokimi* bëhet në bazë të rasteve të paraqitura në qendër, përmes të cilit mundësohet ngritja e vetëdijesimit të institucioneve të cilët janë subjekte të shumë ankesave si për shembull: përmes deklaratave në media (konferencë për shtyp, paraqitja e statistikave të ankesave të pranuar) për të ngritur vëmendjen e institucioneve specifike dhe sigurimin e rekomandimeve për përmirësim.

*Përkrahje në ngritje të kapaciteteve për autoritetet shtetërore për t'i shqyrtuar ankesat e qytetarëve në luftën kundër korrupsionit.* ALAC nuk bënë hulumtim të rasteve, në kuptimin e thirrjes së dëshmitarëve, hulumtimit të informatave, përgjime, hulumtime të pavarura, si dhe gjykime nëse ka pasur korrupsion. Pra, qendra i ndihmon qytetarët dhe institucionet që t'i adresojnë dhe t'i zgjidhin rastet e korrupsionit.

Mënyrat se si mund të raportohen rastet e korrupsionit në qendrën tonë janë : Raportimi përmes linjës telefonike pa pagesë: 0800 777 77 apo raportimi online: [www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org), Raportimi me e-mail: [info@kdi-kosova.org](mailto:info@kdi-kosova.org)